

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: N.SH.H. "ZONA PARK" me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi – U.d. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	29.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 27.08.2019, të parashtruar nga Operatorin Ekonomik: N.SH.H. "ZONA PARK" me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatorin Ekonomik: N.SH.H. "ZONA PARK" me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 22.08.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autortieti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorin Ekonomik: N.SH.H. "ZONA PARK" me adresë në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: 623-19-3485-2-2-1, Nr i brendshëm: 623-19-024-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 22.08.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 27.08.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Pretendimi 1:

1. Supozohet se Autoriteti Kontraktues e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së pasi që nuk i ka trajtuar të gjithë OE-të pjesëmarrës në mënyrë të barabartë por në mënyrë diskriminuese duke mos na trajtuar njëjtë pasi që gjatë rivlerësimit të ofertave nuk ka vepruar sipas dispozitave të LPP-së lidhur me ofertën e kompanisë sonë, sepse na eliminon padrejtësisht edhe pse ne në ankesën e kaluar kemi dëshmuar se plotësojmë të gjitha kërkesat e AK-së në Njoftimin për kontratë dhe FDT.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit nuk pajtohet me Pretendimin e O.E. pasi që e ka respektuar si duhet Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi sipas LPP – së.

Kjo lëndë është Ri-vlerësuar sipas Vendimit të OSHP – së, PSH. nr. 351/19, e datës: 06.08.2019, dhe AK e ka respektuar ne plotësi nenin 7 pargarfi 2, te LPP – së, po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Te tenderi i lartë cekur, kemi patur tetë (8) ofertues, dhe tek ky aktivitet i prokurimit nuk ka patur asnje kriter qe te redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik, ku tek Njoftimi per Kontrat dhe Dosjen e tenderit: **Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)**, ka patur kriteret ne baze te natyres se prokurimit, dhe ju si Operatori Ekonomik i plotësoni të gjitha kushtet sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit: **Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)**, por nuk keni qenë tenderues me çmimin më të ulët, në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pretendimi 2:

2. Supozohet se Autoriteti Kontraktues e ka shkelur Nenin 59 të LPP-së pasi që nuk i ka krahasuar, vlerësuar dhe ekzaminuar ofertat konform kërkesave në dosjen e tenderit.

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka dëshmi të mangëta lidhur me analizat e produkteve të caktuara nga ana tij, të njejtat preparate janë të rrezikshme të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha gjatë përdorimit tek popullata civile, në kafshë dhe bimë.

Dëshmitë mund të ju ofrojmë nga Agjencia Evropiane e kemikateve për preparatet e OE të rekomanduara për kontratë ku tregojnë rrezikshmërinë e këtij produkti.

Autoriteti Kontraktues gjatë Ekzaminimi, Ri-vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, duke u mbështetur ne Vendimin e OSHP – së, PSH. nr. 351/19, e datës: 06.08.2019, ku thotë: sipas Nenit 59 par. 2 te LPP-së po citoj: *"Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues"*.

Komisioni Ri-vlerësues me datë: 15.08.2019, me Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, ka kerkuar nga OE, po citoj: *Sipas VENDIMIT të OSHP-së, PSH.nr. 351/19, e datës:*

06.08.2019, thotë: Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK mund që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilin do nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve.

Kerkojm nga Operatori Ekonomik te beje sqarime me shkrim se produktet e perdorura ne pershkrimin e metodave te punes dhe realizimit te sherbimeve.

Te Specifikimet teknike – Paramasa (Lista e Çmimeve), është kërkuar që substanca të jetë Pyrethroid (acarid), e qe substanca/produktet e ofruara nga OE janë ekuivalente.

Kerkesa e A.K. Komuna e Rahovecit eshte se Produktet apo substanca Aquathrin a eshte e familjes Pyrethroid (acarid).

Ku OE me datë: 15.08.2019, ka bere sqarime te mjaftueshme me pyetjet e parashtruara te Dosjes se tenderit, po citoj:

Preparati **Aqua-K-Othrine** është një insekticid i spektrit të gjerë, i cili përdoret gjerësisht në tërë botën për kontrollimin e insekteve fluturuese dhe jo fluturuese, përfshirë: mushkonjat, mizat, morrat, rriqrat, brumbujt, etj. Ky preparat prodhohet nga kompania e njohur gjermane **Bayer**. Materia aktive e preparatit është **Deltametrina**, Deltametrina për nga struktura dhe përbërja kimike bënë pjesë në grupin e **pyrethroideve** dhe është izomeri më i fuqishëm insekt-mbytës nga 8 stereoizomerët e këtij grupi, ashtu siç është shpjeguar qartë edhe nga vet prodhuesi në **Safety Data Sheet -Fletë Sigurinë e të Dhënave të Materialit**¹. Emërtimi i deltametrinës sipas sistemit IUPAC është **[(S)-Cyano-(3-phenoxyphenyl)-methyl] (1R,3R)-3-(2,2-dibromoethenyl)-2,2-dimethyl-cyclopropane-1-carboxylate**, ndërsa formula molekulare kimike **C₂₂H₁₉Br₂NO₃**, me numër identifikues **CAS 52918-63-5**².

Pyrethroidet janë komponime sintetike analoge të **piretrinës** natyrore, të cilat janë zhvilluar për të rritur aktivitetin insekt-mbytës të **piretrinës** duke rritur qëndrueshmërinë e tyre në prani të dritës dhe kohën e qëndrueshmërisë në mjedis (Gosselin, 1984)³. **Piretrinën natyrore**, janë komponime organike me veprim insekticid të cilat ekstrahohen nga bima **Chrysanthemum scinerariaefolium** (Casida dhe Quistad, 1998)⁴. **Ndërkaq, piretroidet janë derivate të piretrinës, të cilave u mungon një grup ciano. Ato klasifikohen në dy grupe, përkatësisht klasa I dhe klasa II, bazuar në toksicitetin dhe vetitë fizike të tyre.**

Klasa I e pyrethroideve kanë një strukturë themelore të esterit karboksilik të ciklopropanit. Këto përfshijnë aletrinin, bifentrinin, permetrinin, fenotrinin, resmetrinin, teflutrinin dhe tetrametrinin.

Klasa II e pyrethroideve strukturën e tyre kanë një grup ciano dhe te insektet shkaktajnë lëvizje të çrregullta dhe jargosje përkatësisht shkurorë nga sekrecioni i gjëndrave pështymore dhe paralizë të muskujve dhe trupit, si pasojë e veprimit nervor që kanë. Në këtë klasë bëjnë pjesë: ciflutrinin, cihalotrinin, cipermetrinin, **deltametrinin**, fenvaleratin, fenpropatrinin, flucitirinat, flumetrinin, fluvalinatidhetralometrinin.

Pyrethroidet janë efikase kundër një game të gjerë të insekteve dëmtuese që i përkasin rendit Koleoptera, Hemiptera (Homoptera dhe Heteroptera), Diptera, Himenoptera, Lepidoptera, Ortoptera dhe Tisanoptera (Agjencia për Substancat Toksike dhe Regjistrin e Sëmundjeve, 2003)⁵.

Ne lidhje me kete sqarim po ja bashkëangjese edhe Safety Data Sheet e produktit te prodhuesit ku ne si Operatore Ekonomike i kemi pranuar e per lehtesimin tuaj i kemi hijezuar me ngjyre te vegant e ku ky produkt i perket familjes **pyrethroideve**. Poashtu perveq produktit ne fjale ne si Operatore Ekonomike ne pershkrimin dhe metodat e punes kemi shkruar edhe dy produkte tjera si Tibi-24 dhe Aqua-K-Othrine EW20 e ku mundet edhe ky produkt te verifikohet permes linkur te meposhtme qe eshte i familjes se Pyrothroideve. www.nexles.com/eu/bayer-insecticide-aqua-k-othrine-ew-20-1-litre.html

¹<https://resources.bayer.com.au/resources/uploads/msds/file9165.pdf>

²<https://en.wikipedia.org/wiki/Deltamethrin>

³<https://link.springer.com/article/10.1007/s11515-018-1489-z>

⁴<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/9444749>

⁵<https://stacks.cdc.gov/view/cdc/6499>

Ku per Komision e Ri-vlerësimit pergigije e cekura jane te pranueshme dhe te keto produkte jane sipas specifikimit teknik – paramasa e çmimeve.

Gjatë Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të Tenderëve, Grup i Operatorëve Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI” B.I. & N.T.P. “BENI”** me adresë në **Suharekë**, i shpallur si fitues i kësaj procedure, ju Njoftojm se i plotëson të gjitha Kushtet sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit: **Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)** dhe është Tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më ulët.

Ted Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si kriter:

Dëshmia 4: Operatori Ekonomik të sjell dëshmi që ka Leje – Licencë për importim dhe përdorim të produkteve biocide nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor – Kopje.

Grup i Operatorëve Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI” B.I. & N.T.P. “BENI”** me adresë në **Suharekë**, i rekomanduar per kontrat e ka dëshmuar se posedon: Leje – Licencë për importim dhe përdorim të produkteve biocide nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe me këtë dëshmi O.E nuk mund te perdore preparate qe janë të rrezikshme te cilat mund te shkatojnë dëme të mëdha gjatë përdorimit, pasi qe ka licencë përkatëse të kësaj natyre nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Pretendimi 3:

3. Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 61 të LPP-së, pasi që:
OE ekonomik i propozuar për kontratë duke u bazuar në Rregullat për tenderët me çmim jo-normalisht të ulët i plotëson të gjitha kushtet e parapara.

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit nuk pajtohet me Pretendimin e O.E. pasi që: Oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI” B.I. & N.T.P. “BENI”** me adresë në **Suharekë**, nuk i plotëson këto tri (3) kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë nuk mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët.

Pretendimi 4:

Autoriteti Kontraktues supozohet se na ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe morale, nderprerjen e kontratës, mbetjen e punëtorëve pa paga dhe fitimin e parashikuar.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit nuk pajtohet me këtë pretendim te Operatori Ekonomik, pasi qe nuk kemi patur nderprejen e kësaj kontrate, por kemi bere procedure per kontrate te re.

Kjo procedurë eshte trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër ketij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres se Prokurimit
Komuna e Rahovecit